



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Forcës së Sigurisë
Ministarstvo Snaga Bezbednosti Ministry of Security Force

ANKAND PUBLIK

SHITJA E PAJISJEVE DHE MATERIALEVE TË PASHFRYTËZUARA

Me ngritjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), është një numër i pajisjeve të pashfrytëzuara të cilat do të shiten në mënyrë publike. Shitja është duke u realizuar nga Qeveria e Kosovës dhe mbikëqyrur nga KFOR-i. Të gjitha të hyrat nga kjo shitje do të derdhen në Qeverinë e Kosovës.

Shumë lloje të ndryshme të automjeteve, mobileve dhe orendive të tjera, metaleve të vjetra, pjesëve të vjetra të drurit dhe artikujve të ndryshëm të pashfrytëzuar, janë për shitje. Shumë prej automjeteve kanë vlera të konsiderueshme të pjesëve rezervë dhe të atyre për hedhje. Të gjithë artikujt duhet të shiten në kushtet në të cilat janë të ekspozuar. Të gjitha shitjet janë përfundimtare dhe të pakthyeshme.

Do të bëhet një shikim i pajisjeve në secilin lokacion i cili do të pasohet menjëherë nga një ankand. Blerësit ftohen që t'i shikojnë pajisjet në secilën Kazerëm të FSK-së në kohërat si në vijim:

13 korrik Kazerma e Prishtinës.	Shikimi 0900 – 1200. Ankandi 1300 – 1500.
14 korrik Kazerma e Ferizajit.	Shikimi 0900 – 1200. Ankandi 1300 – 1500.
15 korrik Kazerma e Prizrenit.	Shikimi 0900 – 1200. Ankandi 1300 – 1500.
16 korrik Kazerma e Pejës.	Shikimi 0900 – 1200. Ankandi 1300 - 1500.
17 korrik Kazerma e Gjilanit.	Shikimi 0900 – 1200. Ankandi 1300 - 1500.
20 korrik Kazerma e Pomozatinit.	Shikimi 0900 – 1200. Ankandi 1300 - 1500.
21 korrik Fabrika e Municionit Skenderaj.	Shikimi 0900 – 1200. Ankandi 1300 - 1500.
22 korrik Kazerma e Vranidollit.	Shikimi 0900 – 1200. Ankandi 1300 - 1500.

Pas shikimit të artikujve për shitje do të mbahet ankandi për secilin artikull ndarazi dhe për grupe artikujsh. Do të jenë pesë kategori të ankandit:

- Automjetet – ankandi do të zhvillohet ndarazi
- Gjeneratorët – ankandi do të zhvillohet ndarazi
- Kompjuterët dhe pajisjet e TI-së – ankandi do të zhvillohet në grupe
- Pajisje të përgjithshme – ankandi do të zhvillohet në grupe
- Metale dhe pjesët e drurit për hedhje - ankandi të zhvillohet në grupe

Fituesit e secilit artikull të ven në ankand do të paguajnë në para të gatshme deri në ora 16:00.

Artikujt e blerë duhet të largohen nga objekti i FSK-së nga vet blerësit jo më vonë se 28 korriku, ora 1600.